



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.640/10 prot.

Datë 06.04.2024

V E N D I M
Nr. 348/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.04.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të KPP nr. 299/2024, datë 25.03.2024, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-97588-03-06-2024 me objekt “Blerje pajisje kompjuterike për nevoja të Administratës dhe Drejtorisë së Urbanistikës pranë Bashkisë Lezhë”, me fond limit 3,408,025.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 18.03.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK me NIPT K71903025A, me adresë Rruga “Gjin Bue Shpata”, Godina. Vjetër, Hyrja 7, Ap. 34, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Lezhë me adresë L. Skenderbeg, Sheshi “Gjergj Kastrioti”, 4501, Lezhë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 25.03.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 299/2024 ku vendosi:

- 1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK, lidhur me procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-97588-03-06-2024, me objekt “Blerje pajisje kompjuterike për nevoja të Administratës dhe Drejtorisë së Urbanistikës pranë Bashkisë Lezhë”, me fond limit 3,408,025.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 18.03.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhe*
- 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me anulimin e procedurës së prokurimit të sipërpërmendur.*
- 3. Autoriteti kontraktor të dërgojë në Komisionin e Prokurimit Publik formularin për anulimin e procedurës së prokurimit objekt - shqyrtimi.*
- 4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
- 5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK.*
- 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 7. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 2630/16 prot., datë 03.04.2024 protokolluar me tonën nr. 640/7 prot., datë 05.04.2024 autoriteti kontraktor njofton se e ka zbatuar vendimin e KPP-së nr. 299/2024 datë 25.03.2024.

I.3. Nga verifikimi rezulton se bashkëlidhur shkresës së mësipërme autoriteti kontraktor ka dorëzuar formularin e njoftimit të anulimit të procedurës me nr. 2630/15 prot., datë 02.04.2024 për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-97588-03-06-2024 me objekt “Blerje pajisje kompjuterike për nevoja të Administratës dhe Drejtorisë së Urbanistikës pranë Bashkisë Lezhë”, me fond limit 3,408,025.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 18.03.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 2630/16 prot., datë 03.04.2024 protokolluar me tonën nr. 640/7 prot., datë 05.04.2024 autoriteti kontraktor njofton se e ka zbatuar vendimin e KPP-së nr. 299/2024 datë 25.03.2024.

II.2. Nga verifikimi rezulton se bashkëlidhur shkresës së mësipërme autoriteti kontraktor ka dorëzuar formularin e njoftimit të anulimit të procedurës me nr. 2630/15 prot., datë 02.04.2024 për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-97588-03-06-2024 me objekt “Blerje pajisje kompjuterike për nevoja të Administratës dhe Drejtorisë së Urbanistikës pranë Bashkisë Lezhë”, me fond limit 3,408,025.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 18.03.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë.

II.3. Sa më sipër, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë e ka zbatuar vendimin Nr. 299/2024, datë 25.03.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-97588-03-06-2024 me objekt “Blerje pajisje kompjuterike për nevoja të Administratës dhe Drejtorisë së Urbanistikës pranë Bashkisë Lezhë”, me fond limit 3,408,025.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 18.03.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-97588-03-06-2024 me objekt “Blerje pajisje kompjuterike për nevoja të Administratës dhe Drejtorisë së Urbanistikës pranë Bashkisë Lezhë”, me fond limit 3,408,025.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 18.03.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiovent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

